REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

RAPORTI VJETOR

2020

www.asd.gov.al
t: +355 (4) 2362 989/2347 298
f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al
Rruga e Elbasanit, Nr. 317, Tiranë

TRYEZA E LËNDËS

Seksioni 1 – Rreth këtij Raporti 3
1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm. 4
1.2. Reagimi i Agjencisë ndaj situatës së krijuar nga Covid-19. 8
1.3. Përmbledhje Ekzekutive. 10
Seksioni 2 - Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe vënia në zbatim e rekomandimeve të saj nga Agjencia. 12
Seksioni 3 – Vështrim i përgjithshëm mbi depozitat. 17
3.1. Depozitat në banka dhe shkk. 17
3.2. Sigurimi i depozitave në banka. 18
3.2.1. Depozitat e siguruesshme në sistemin bankar. 18
3.2.2. Depozitat e siguruesshme të individëve. 21
3.2.3. Depozitat e siguruara të individëve. 24
3.2.4. Depozitat e siguruesshme të tregtarëve e shoqërive tregtare. 26
3.2.5. Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare. 28
3.3. Sigurimi i depozitave në shkk. 29
3.3.1. Depozitat e siguruesshme në shkk. 30
3.3.2. Depozitat e siguruara në shkk. 32
3.4. Procesi i verifikimit të subjekteve anëtare të skemës. 34
Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të Agjencisë. 36
4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka. 36
4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka. 36
4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka. 36
4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka. 38
4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në shkk. 39
4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në shkk. 39
4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në shkk. 39
4.3. Administrimi i mjeteve financiare. 41
Seksioni 5 – Projektet e realizuara për fuqizimin e skemës së sigurimit të depozitave. 44
5.1 Projekti për vlerësimin e parametrave financiarë të skemës së sigurimit të depozitave. 44
5.2. Projekti për krijimin e masterplanit të një sistemi të integruar të sigurimit të depozitave. 46
Seksioni 6 – Mirëqeverisja e institucionit. 47
6.1. Këshilli Drejtues. 47
6.2. Struktura organizative. 49
Seksioni 7 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. 51
Seksioni 8 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. 58
8.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. 58
8.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme 60

Seksioni 1 – Rreth këtij Raporti

Ky Raport Vjetor ofron një panoramë të veprimtarisë financiare dhe administrative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për periudhën 1 Janar 2020 deri në 31 Dhjetor 2020. Raporti pasqyron aktivitetet dhe iniciativat kryesore, duke synuar që të gjithë përfituesit e skemës së sigurimit të depozitave, bashkëpunëtorët, partnerët dhe publiku të informohen mbi parimet mbi të cilat është ngritur skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri dhe angazhimin e Agjencisë si administratore e saj për të krijuar sa më shumë vlerë. Ky Raport Vjetor është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar me Ligjin nr. 39/2016 dhe Ligjin nr. 132/2016, Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë.

Pasqyrat financiare pasqyrojnë pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2020 si dhe performancën e saj financiare e flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë. Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të"). Bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë auditohen dhe certifikohen nga auditues të jashtëm të specializuar.

Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Këshilli Drejtues ka ushtruar tagrat që i jep Ligji për t' u siguruar që Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën dhe administrimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit në raportim.

Jeni të lutur të jepni komentet tuaja për Raportin Vjetor 2020 në adresën info@asd.gov.al. Ky Raport Vjetor, si dhe raportet vjetore të mëparshme, mund të konsultohen në faqen tonë zyrtare të internetit www.asd.gov.al.

1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm.

I nderuar lexues,

Me kënaqësi ju prezantojmë Raportin Vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020. Ky Raport, si çdo vit, përmbush jo vetëm detyrimin ligjor të Agjencisë, për të raportuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë dhe institucionet e tjera të përcaktuara nga ligji, por edhe detyrimin e transparencës për publikun sa i takon të gjithë veprimtarisë dhe aktiviteteve të zhvilluara përgjatë vitit në raportim.

Viti 2020 ka qenë një vit jo i zakonshëm për shkak të krizës shëndetësore të shkaktuar nga pandemia globale COVID-19. Kjo pandemi ndikoi jetët tona duke na kushtëzuar mënyrën e të jetuarit përfshirë këtu dhe ndikimet në financat individuale dhe publike. Mirëqenia globale përjetoi një sërë goditjesh të pashembullta, të cilat i detyruan qeveritë dhe autoritetet të merrnin një sërë masash për të mitiguar rreziqet shëndetësore dhe financiare që buronin nga kjo krizë. Ashtu si në të gjithë botën, edhe në Shqipëri autoritetet përgjegjëse reaguan menjëherë duke ndërvepruar dhe koordinuar përpjekjet me synim minimizimin, përmes politikave mbështetëse, të efekteve negative ekonomike dhe kthimin sa më shpejt në normalitet.

Në këtë kuadër, Autoriteti Mbikëqyrës i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Banka e Shqipërisë, ndërmori një sërë masash me qëllim zbutjen e efekteve negative në mirëqenien e bizneseve dhe individëve, si dhe krijimin e premisave për një rimëkëmbje sa më të shpejtë të ekonomisë në periudhën vijuese. Edhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë, u angazhua në përpjekjet për përballimin e situatës duke ruajtur sigurinë e operacioneve dhe aktiviteteve të saj, duke monitoruar në mënyrë frekuente veprimtarinë e anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave si dhe duke koordinuar veprimet dhe shkëmbimin e informacionit me të gjitha autoritetet ligjvënëse, rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Në këtë këndvështrim, ju bëjmë me dije se, pavarësisht situatës së jashtëzakonshme të pandemisë, parametrat e funksionimit të sistemit bankar dhe financiar mbetën të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm përgjatë vitit në raportim. Kjo qëndrueshmëri dëshmohet nga ecuria pozitive e depozitave në sistemin bankar dhe atë të shkk-ve. Depozitat gjatë vitit 2020 njohën një rritje përkatësisht prej 7,8% në sistemin bankar dhe pothuajse 6% në shkk. Rritja e depozitave sjell si pasojë dhe rritjen e fondeve të sigurimit të depozitave që Agjencia administron. Si rrjedhojë rritja vjetore e fondit të sigurimit të depozitave në banka është 10.9%, ndërsa fondi i sigurimit të depozitave në shkk u rrit gjatë këtij viti me 16.1%. Kjo rritje mbështetet nga rezultati financiar pozitiv i Agjencisë prej 4,7 miliard lekë. Agjencia, gjithashtu, që prej vitit 2017, administron Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në banka, i cili gjatë vitit 2020 ka shënuar një rritje prej 53%. Janë pikërisht këto fonde, administrimi i tyre me përgjegjshmëri e transparencë si dhe aftësia e kapaciteteve operacionale të Agjencisë, që shërbejnë si një nga elementët kryesorë të garancisë për depozituesit dhe si rrjedhojë një nga shtyllat kryesore të stabilitetit financiar në vend. Të gjitha këto mundësuan që niveli i mbulimit për depozitat e siguruara në sistemin bankar në fund të vitit 2020 të arrinte 6,46%.

Gjatë vitit 2020, edhe pse të kushtëzuar nga kufizimet si pasojë e pandemisë, kemi realizuar të gjitha iniciativat dhe projektet e planifikuara, të cilat kanë pasur si synim kryesor gatishmërinë e të gjitha burimeve të Agjencisë për të përmbushur mandatin ligjor. Përgjegjësia jonë kryesore, si institucioni i sigurimit dhe kompensimit të depozitave në Shqipëri, është të jemi të gatshëm të mirëadministrojmë në situata kur një anëtar i skemës së sigurimit të depozitave mund të kalojë një periudhë jo të qëndrueshme financiare. Projektet që kemi realizuar për këtë qëllim, gjykojmë që e kanë përmirësuar nivelin e gatishmërisë së Agjencisë.

Si shembull, në këtë drejtim, mund të përmendim hartimin dhe miratimin e “Platformës për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar”. Adresimi i problematikave që lidhen me cilësinë e të dhënave të depozituesve, e konsideruar si një domosdoshmëri për një proces kompensimi të saktë dhe të shpejtë, ka qenë gjithmonë prioritet i Agjencisë. Për këtë arsye, në vitin 2020, në zbatim edhe të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për aktivitetin e Agjencisë, u hartua platforma e sipërpërmendur, e cila

unifikon të gjitha përpjekjet dhe angazhimet e aktorëve të përfshirë që në përputhje me afatet e përcaktuara të përmirësojnë në mënyrë cilësore të dhënat e depozituesve në sistemin bankar. Si një angazhim, suksesi i të cilit kërkon kontributin e të gjithëve, kjo platformë u realizua në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave.

Teknologjia po zë gjithmonë e më shumë një vend thelbësor në jetët tona, veçanërisht në kushtet e krijuara së fundmi. Për këtë arsye autoritetet rregullatore duhet shfrytëzojnë të gjitha lehtësirat teknologjike në mënyrë që të rrisin sa më shumë të jetë e mundur efikasitetin e veprimtarisë së tyre. Në këtë drejtim, një projekt tjetër shumë i rëndësishëm i realizuar në vitin 2020, ishte ai për zhvillimin dhe modernizimin e sistemit informatik të raportimit dhe kompensimit të Agjencisë. Ky projekt, i cili ka një rëndësi thelbësore në aspiratat e Agjencisë për të trajtuar me efikasitet një ngjarje sigurimi, krijoi masterplanin e një sistemi të integruar për sigurimin dhe kompensimin e depozitave në Shqipëri. Vlen të theksojmë dhe njëkohësisht të falënderojmë Korporatën Koreane të Sigurimit të Depozitave, një nga institucionet më të përparuar në botë sa i takon sigurimit të depozitave, për asistencën teknike, mbështetjen dhe kontributin në realizimin e këtij procesi kaq të rëndësishëm.

Një projekt tjetër, shumë me vlerë, që u realizua me asistencën teknike të zyrës FinSac të Bankës Botërore kishte të bënte me vlerësimin e parametrave financiarë të skemës së sigurimit të depozitave dhe hartimin e metodologjive për vlerësimin e tyre. Ky projekt, i bazuar në të dhëna statistikore ekonomike dhe të sistemit bankar në Shqipëri, vlerësoi si mjaft të përshtatshëm parametrat financiarë të skemës së sigurimit të depozitave, duke përmbushur në këtë mënyrë dhe detyrimin e ligjor për vlerësimin, çdo pesë vjet, të përputhshmërisë së niveleve maksimale të mbulimit, me kushtet ekonomike dhe sociale të Republikës së Shqipërisë dhe standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave. Pjesë e projektit ishte dhe ndërtimi i metodologjisë stres-test për vlerësimin e përshtatshmërisë së madhësisë së synuar të fondeve të sigurimit të depozitave të administruara nga Agjencia, çka do të ndikojë në përmirësimin e aftësive të institucionit për të qenë proaktivë në vlerësimin e mundësisë së ndodhjes të një ngjarje sigurimi.

Më lart ju informuam shkurtimisht për ecurinë e aktivitetit të depozitave si dhe projektet kryesore që Agjencia ka kryer në vitin 2020. Në faqet e këtij raporti do të keni mundësinë të njiheni me detaje sa i takon trendeve dhe ecurisë së depozitave në sistemin bankar dhe atë të shkk-ve, mbi administrimin e burimeve financiare të Agjencisë si dhe veprimtarinë e Agjencisë në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore. Në mbyllje, dëshirojmë të vlerësojmë dhe falënderojmë Këshillin Drejtues dhe personelin e Agjencisë të cilët, pavarësisht kufizimeve të vendosura prej pandemisë Covid-19, kryen një tranzicion të shpejtë dhe efikas të të punuarit në distancë. Pavarësisht se ku punojmë ne vazhdojmë të shërbejmë dhe përmbushim objektivat tonë me përkushtim. Në këtë këndvështrim, jemi besimplotë se të gjitha aktivitetet e realizuara na kanë përgatitur për të përballuar sfidat e mundshme, duke patur si qëllim parësor mbrojtjen e interesave të depozituesve shqiptarë dhe kontribuar maksimalisht në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

Ju faleminderit.

Donald Duraj — Genci Mamani

Kryetar i Këshillit Drejtues — Drejtor i Përgjithshëm

1.2. Reagimi i Agjencisë ndaj situatës së krijuar nga Covid-19.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2020 përshtati veprimtarinë e saj operacionale në përputhje me kushtet e reja të krijuara nga pandemia globale Covid-19. Në këtë këndvështrim, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet dhe autoritetet shtetërore dhe rregullatore, Agjencia ndërmori hapa në mbështetje të stabilitetit të sistemit bankar e financiar, për monitorimin e ecurisë së treguesve të anëtarëve të skemës dhe ruajtjes së integritetit të operacioneve të saj.

Duke vlerësuar sa më sipër, Agjencia në përputhje me objektivat e saj ligjorë për të mbrojtur interesat e depozituesve dhe për të kontribuar në stabilitetin e sistemit bankar e financiar, me qëllim rritjen e likuiditetit dhe kapacitetit financiar të saj, inicioi procesin e negociatave me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për të përfituar një linjë kredie në dispozicion. Linja e kredisë konsiderohet si një mekanizëm më shumë, që u shtohet elementëve të sigurisë së skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri.

Me qëllim, monitorimin e situatës dhe ecurisë së treguesve të anëtarëve të skemës, Agjencia në mënyrë periodike gjatë vitit 2020 intensifikoi mbledhjen e informacionit ditor mbi depozitat dhe lëvizjet e tyre nga të gjitha bankat dhe shkk-të. Gjatë kufizimit të lëvizjes dhe më tej, Agjencia siguroi vijimësinë e veprimtarisë së saj operacionale, nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta intensive on-line. Në këtë drejtim, janë realizuar verifikime në distancë në të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit anëtare të skemës së sigurimit të depozitave dhe ushtrime të simulimit me bankat agjente. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh, që punonjësit e shërbimit me klientin janë përcjellësit e parë të informacionit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, Agjencia edhe në këtë vit të vështirë, ka organizuar takime, konsultime dhe trajnime on-line me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Për të gjitha këto aktivitete janë përdorur mjetet e teknologjisë së informacionit të Agjencisë dhe subjekteve anëtare të skemës.

Gjithashtu, në kuadër të pandemisë Covid-19, Agjencia konsideroi shumë të rëndësishëm vlerësimin sa më të hershëm të situatës financiare të subjekteve anëtare të skemës. Për këtë qëllim, me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore, u përgatit një metodologji për kryerjen e stres-testeve, e cila vlerësohet se do të përmirësojë kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese të Agjencisë.

Në zbatim të masave të autoriteteve shëndetësore, gjatë vitit 2020 një pjesë e personelit të Agjencisë ka vijuar punën në distancë, ndërkohë që për procese pune të cilat e kanë të domosdoshme praninë fizike të punonjësve në institucion, u zbatuan masat e miratuara anti-covid. Gjithashtu, mbledhjet e Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, janë zhvilluar sipas kalendarit të planifikuar që në fillim të vitit, por duke përdorur platformat e komunikimit on-line dhe duke vënë në zbatim për vendimmarrje procedurat e vendimeve qarkulluese.

1.3. Përmbledhje Ekzekutive.

Totali i depozitave në sistemin bankar në fund të muajit Dhjetor 2020, arriti në nivelin e 1,286.4 miliard lekë, prej të cilave Agjencia ka detyrimin për kompensim në masën prej 741.6 miliard lekë, apo 1,710,112 depozitues. Vlera e depozitave të siguruesshme në banka që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,226 miliard lekë, çka përfaqëson 95.3% të totalit të depozitave. Depozitat e siguruesshme të individëve zënë peshën më të madhe të depozitave të siguruesshme, konkretisht rreth 84 % të tyre, ndërkohë që 16 % janë depozita të siguruesshme të tregtarëve dhe shoqërive tregtare. Depozitat e siguruesshme në lekë, në fund të dhjetorit 2020, zënë 49.4% të totalit të depozitave të siguruesshme, ndjekur nga depozitat në euro me 43.8%, dhe depozitat në USD 4.9%, duke ruajtur raporte të përafërta me një vit më parë.

Ndërkaq, totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit është 8.7 mld lekë në fund të vitit 2020. Depozitat e siguruesshme në shoqëritë e kursim-kreditit përbëjnë 98.3% të totalit, me një vlerë prej 8.5 mld lekë, në përfitim të 39,153 depozituesve. Në fund të vitit 2020, depozitat e siguruesshme në monedhë të huaj zënë 17% të totalit të depozitave të siguruesshme në shoqëritë e kursim-kreditit, ndërkohë që pjesa e mbetur janë depozita në lekë. Detyrimi për kompensim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit është 6.3 mld lekë. Kjo shumë përbën 73% të totalit të depozitave, ose 74.2% të depozitave të siguruesshme.

Fondet e sigurimit të depozitave në banka dhe në shoqëritë e kursim-kreditit janë rritur në mënyrë të qëndrueshme përgjatë vitit 2020. Konkretisht, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka në fund të vitit 2020 është 47.9 mld lekë, me një rritje vjetore prej 4.71 mld lekë ose 10.9 %. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së të ardhurave nga primet e sigurimit, të cilat në vitin 2020 ishin 3.57 mld lekë me një rritje prej 5.79 %, si dhe rritjes së të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare, në vlerën 1.22 mld lekë ose 13.4 % më shumë se në vitin 2019. Ashtu si dhe vitin e kaluar, këtë vit rritja e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare ka ardhur kryesisht si rezultat i zgjerimit të portofolit në obligacione me maturitet 2 dhe mbi dy vjet. Rritja e qëndrueshme e fondeve të sigurimit të depozitave në banka ka sjellë një rritje të raportit të mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, në 6.46% në fund të vitit 2020 nga 6.15 % në vitin 2019.

Ndërkohë, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, në të njëjtën periudhë, është 144.70 mln lekë, duke shënuar një rritje prej 16.14 %. Të ardhurat vjetore nga primet e sigurimit për vitin 2020 ishin 18.54 mln lekë, ndërsa të ardhurat vjetore nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit përgjatë vitit 2020 ishin 1.97 mln lekë, me një rritje prej 14.92 %. Së fundmi, raporti i mbulimit për vitin e tretë të funksionimit të skemës së sigurimit për SHKK-të është 2.28 %.

Përgjatë këtij viti, Agjencia u angazhua gjithashtu në përmbushjen e funksioneve të ngarkuara nga ligji për administrimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (FNJ), si viti i tretë i derdhjes së kontributeve vjetore nga bankat për këtë fond. Vlera kontabël e FNJ-së në fund të vitit 2020 është 1.997 mld lekë. Totali i kontributit vjetor të paguar nga bankat ishte në shumën 654.202 mln lekë. Mjetet financiare të FNJ-së janë administruar sipas politikës së administrimit të miratuar nga Agjencia dhe Banka e Shqipërisë, si Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Seksioni 2 - Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe vënia në zbatim e rekomandimeve të saj nga Agjencia.

Agjencia, në përmbushje të mandatit të saj publik dhe në zbatim të përcaktimeve ligjore të Ligjit nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, raporton në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë e saj vjetore. Në vijim të raportimit për aktivitetin e saj në vitin 2019, Kuvendi me anë të "Rezolutës për Vlerësimin e Veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për Vitin 2019", miratuar në datë 02.07.2020, vlerësoi aktivitetin vjetor të institucionit si dhe rekomandoi pesë drejtime kryesore në të cilat Agjencia duhej të përqendronte angazhimin e saj për vitin 2020. Përgjatë vitit në raportim, Agjencia përmes iniciativave operacionale dhe projekteve me partnerët e saj strategjikë ka realizuar rekomandimet e Kuvendit. Në vijim do të gjeni rekomandimet e Kuvendit si dhe masat e ndërmarra nga Agjencia për vënien e tyre në zbatim.

Rekomandimi 1: Ndjekjen e problematikave të konstatuara gjatë verifikimeve në të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit që janë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave dhe rekomandimeve dhe afateve të lëna nga ASD, duke mbajtur parasysh rëndësinë e saktësisë së raportimit të skedarëve për plotësimin e objektivit kryesor të Agjencisë, kompensimin e depozituesve në rast të një ngjarjeje kompensimi.

Masat e marra nga Agjencia: Agjencia si në çdo fillim viti, edhe në fillim të vitit 2020, organizoi takimin vjetor me bankat, dhe një tjetër takim me shoqëritë e kursim-kreditit, takime në të cilat iu vu theksi: së pari, ndjekjes, zbatimit, si dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportet e verifikimit; së dyti, përgatitjes, raportimit/ngarkimit të skedarëve për simulim/kompensim, si dhe përmirësimit të këtij raportimi. Në vijim gjatë 6-mujorit të parë 2020, Agjencia ka kryer simulime teknike me të gjitha shoqëritë e kursim-kreditit. Ngarkimi i skedarëve për të gjitha shoqëritë e kursim-kreditit anëtare të skemës së sigurimit të depozitave ka rezultuar me sukses. Agjencia ka kryer verifikimin on-line në të gjitha shoqëritë e kursim-kreditit, fillimisht me takime individuale on-line, dhe në vijim me dokumente të skanuara dhe raportime elektronike duke përfunduar me dërgimin e raportit të verifikimit.

Gjithashtu, është realizuar dhe faza vijuese e masave të marra në funksion të këtij rekomandimi, në të cilën është kryer simulimi teknik me të gjitha bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.

Gjatë vitit 2021, Agjencia do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim – kreditit, për ndjekjen dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë simulimeve teknike.

Rekomandimi 2: Hartimin dhe vënien në zbatim të platformave, që synojnë përmirësimin dhe cilësinë e të dhënave të depozituesve duke vendosur afate dhe parametra të caktuar, veçanërisht adresimin e çështjeve të lidhura me numrin personal, mungesa e të cilit është problematike edhe në funksion të plotësimit të objektivave të Agjencisë.

Masat e marra nga Agjencia: Në zbatim të këtij Rekomandimi Agjencia ka hartuar një platformë strategjike për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave, me tregues, masa dhe afate konkrete, bazuar në propozimet e ardhura nga vetë bankat, si dhe në propozimet e Agjencisë të cilat vijnë nga eksperienca e procesit të verifikimeve të kryera në banka.

Në vijim të takimeve me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave, në të cilat u dakordësua që platforma të zyrtarizohet me nënshkrimin e të tre palëve, u zhvilluan takime konsultative me bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.

"Platforma për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar" u nënshkrua në muajin dhjetor 2020 ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Platforma është një plan i përbashkët që angazhon Bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave për kryerjen e veprimeve që ndihmojnë dhe krijojnë kushte për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar. Kjo platformë do t'i mundësojë Agjencisë monitorimin e përmirësimit të cilësisë së të dhënave nga bankat anëtare të skemës.

Platforma e përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave, konsiderohet e një rëndësie thelbësore për Agjencinë, pasi kontribuon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në

realizimin me sukses të objektivave publikë të skemës të sigurimit të depozitave dhe përmbushjen e mandatit ligjor të saj.

Rekomandimi 3: Përfundimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve për realizimin e planit strategjik 2018-2020, që përmbante tri prioritetet strategjike për Agjencinë në periudhën afatmesme.

Masat e marra nga Agjencia: Në zbatim të këtij rekomandimi, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, ka kryer monitorimin në vazhdimësi të ecurisë së realizimit të iniciativave strategjike të parashikuara në Planin Strategjik 2018-2020. Progresi i bërë si në nivel strukture ashtu edhe në nivel institucioni ka qënë objekt raportimi periodik në Këshillin Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Plani Strategjik 2018-2020 kishte identifikuar tre prioritete strategjike, të cilat ishin (i) Zhvillimi i një skeme sa më efikase të sigurimit të depozitave; (ii) Menaxhimi i kapitalit njerëzor; dhe (iii) Zhvillim Strategjik i Partneritetit. Vlen të theksohet se edhe pse të ndikuar nga pandemia e virusit Covid-19, iniciativat të parashikuara janë realizuar në mënyrë të konsiderueshme me një ecuri sipas planifikimit. Si konkluzion, analiza e performancës operacionale dhe organizative të Agjencisë, bazuar në objektivat e Planit Strategjik 2018-2020, vlerësoi se strategjitë e realizuara e kanë përafruar Agjencinë me vizionin e saj për të qenë siguruesi i depozitave që meriton besimin e publikut.

Rekomandimi 4: Ndjekjen e efektivitetit dhe ecurisë së mjeteve financiare të fondit, të investuara në përputhje me strategjinë vjetore të investimit për vitet 2018 dhe 2019, miratuar nga Komiteti i Investimeve i Agjencisë, në përputhje me funksionin e ASD-së si administruese e këtyre mjeteve financiare të fondit.

Masat e marra nga Agjencia: Menaxhimi efektiv i mjeteve financiare të Agjencisë përbën një nga objektivat kryesore të mirë-administrimit të skemës së sigurimit të depozitave. Angazhimi dhe bashkëpunimi i strukturave që përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e investimeve, ndjekja e ecurisë së tyre dhe vlerësimi dhe menaxhimi me efektivitet i rreziqeve financiare të mundshme të portofolit të Agjencisë, është një nga prioritetet e Agjencisë në arritjen e objektivave strategjikë të saj.

Ecuria e portofolit të mjeteve financiare ka qenë mjaft pozitive për vitet 2018 dhe 2019, duke shënuar rritje me 10 % në secilin vit. Gjithashtu edhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare kanë ardhur në rritje gjatë këtyre viteve, pavarësisht presionit të rënies së normave të interesit të titujve. Agjencia siguron pothuajse 25% të ardhurave vjetore nga administrimi i mjeteve financiare të saj.

Agjencia ka ngritur strukturat e nevojshme për zbatimin dhe ndjekjen në vijueshmëri të strategjisë vjetore të investimit si edhe monitorimin e treguesve financiarë, për fondet e kompensimit të depozitave dhe fondin e ndërhyrjes se jashtëzakonshme, të cilat informojnë dhe raportojnë periodikisht në Këshillin Drejtues.

Rekomandimi 5: Të vijohet me verifikimin e efektshmërisë së trajnimeve të punonjësve të bankës, të cilët janë në kontakt me klientelën, si përcjellësit e parë dhe më të rëndësishëm të informacionit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, duke u siguruar për nivelin dhe cilësinë e dijeve të tyre profesionale për sigurimin dhe kompensimin e depozitave bankare.

Masat e marra nga Agjencia: Agjencia në zbatim të këtij rekomandimi të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, duke ju përshtatur kushteve të krijuara nga pandemia e Covid-19, vazhdoi aktivitetin e saj për rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve të subjekteve anëtare të skemës së sigurimit të depozitave sa i takon njohurive të tyre për skemën e sigurimit të depozitave dhe tiparet e saj.

Për këtë qëllim u zhvillua në muajin Shtator një takim on-line me Drejtues të Departamenteve të Marrëdhënieve me Publikun, të Departamenteve të Marketingut, të Departamenteve të Komunikimit të të gjithë bankave anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Takimi synonte diskutimin e strategjive dhe bashkërendimin e përpjekjeve të përbashkëta për adresimin e çështjeve dhe problematikave që lidhen me komunikimin me depozituesit dhe publikun.

Në vazhdën e masave të marra nga Agjencia për adresimin e këtij rekomandimi të Kuvendit, në muajin Dhjetor u realizua një trajnim on-line me punonjësit përgjegjës të shërbimit me klientët, në të gjitha bankat e sistemit. Ky takim kishte për qëllim vijimin e trajnimit të punonjësve të

bankave, të cilët janë në kontakt me klientelën, si përcjellësit e parë dhe më të rëndësishëm të informacionit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave.

Agjencia për t'u siguruar për nivelin dhe cilësinë e dijeve profesionale të punonjësve të bankave, lidhur me sigurimin dhe kompensimin e depozitave bankare, shpërndau një pyetësor për të testuar njohuritë e përgjithshme të punonjësve, në lidhje me procesin e kompensimit të depozitave. Ky pyetësor u plotësua nga të gjithë punonjësit e degëve të të gjitha bankave anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.

Në fokus të takimit ishte rritja e gatishmërisë së subjekteve për ngarkimin e shpejtë dhe të saktë të skedarëve për kompensim, në sistemin elektronik të Agjencisë, me qëllim përgatitjen e listë pagesës me të dhënat unike të depozituesve si edhe vlerësimi i këtij procesi nga Agjencia, nëpërmjet organizimit të simulimeve teknike dhe të përgjithshme. Agjencia kërkoi bashkëpunimin e ngushtë në vijimësi me bankat anëtare të skemës, në zbatim të "Platformës së përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar".

Për vitin 2021, Agjencia ka planifikuar të verifikojë në vijueshmëri, rezultatet e testimeve të dijeve në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave, të realizuar nga vetë bankat e siguruara, si dhe të propozojë materiale trajnuese për përmirësimin e këtyre dijeve për punonjësit e shërbimit të klientelës.

Seksioni 3 – Vështrim i përgjithshëm mbi depozitat.

3.1. Depozitat në banka dhe shkk.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2020 ka siguruar depozitat e depozituesve në 12 banka të sistemit, si dhe në 7 shoqëri kursim-krediti.

Në fund të vitit 2020 totali i depozitave në sistemin bankar ishte 1,286.4 mld lekë, ndërsa totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit ishte 8.7 mld lekë.

Totali i depozitave në banka dhe shkk, për fund vitin 2020



Agjencia sipas të dhënave për fund vitin 2020 ka detyrimin për kompensimin e 741.6 mld lekë depozitave në banka, apo të 1,710,112 depozituesve; si dhe detyrimin për kompensimin e 6.**3** mld lekë depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, apo të 19,024 depozituesve. Në totalin e detyrimeve të Agjencisë, prej 747.9 mld lekë, ndaj depozituesve që kanë vendosur depozitat e tyre në banka dhe shkk, 99.2% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë vendosur depozitat e tyre në banka, ndërsa 0.8% është detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë të vendosura depozitat e tyre në shoqëritë e kursim-kreditit.

Depozituesi në çdo bankë apo në çdo degë të bankës së huaj sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ndërsa depozituesi në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre.

3.2. Sigurimi i depozitave në banka.

Gjatë vitit 2020, totali i depozitave të sistemit bankar ka pasur trend rritës për periudhën më të madhe të tij, me norma të ndryshimit mujor relativisht të ulëta. Në fund të dhjetorit 2020, totali i depozitave në sistemin bankar arriti 1,286.4 mld lekë. Norma mesatare e ndryshimit vjetor për dhjetë vitet e fundit rezulton 4.8%.

Ecuria e depozitave të sistemit bankar për fund vitet 2002-2020



3.2.1. Depozitat e siguruesshme në sistemin bankar.

Në fund të vitit 2020, vlera e depozitave të siguruesshme që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,226 mld lekë, duke përfaqësuar 95.3 % të totalit të depozitave. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 7.4%, ndërsa rritja në vlerë absolute është 85 mld lekë. Depozitat e siguruesshme përfshijnë depozitat me afat, llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimit, llogaritë e kartave, llogaritë e përbashkëta dhe produkte të tjera të ngjashme.

Depozitat e siguruesshme në lekë, në fund të dhjetorit 2020, zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të siguruesshme prej 49.4%, ndjekur nga depozitat në euro, me kundërvlerën e tyre në lekë me 43.8%, dhe depozitat në USD, me kundërvlerën e tyre në lekë, me 4.9%. Krahasuar me një vit më parë vërehet një tendencë në rritje e depozitave të siguruesshme në lekë, kundrejt

depozitave në euro. Pesha e depozitave në lekë u rrit me 0.9%, pesha e depozitave në euro u ul me 1.3%, dhe pesha e depozitave në USD u rrit me 0.4%.

Struktura e shumës së depozitave të siguresheme të sistemit sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2020



Ecuria e depozitave të siguresheme në lekë gjatë vitit 2020 ka qenë pozitive në shumicën e periudhës, por normat e ndryshimit mujor kanë qenë relativisht të vogla, dhe vetëm në muajin mars ka pasur një rënie relativisht të lehtë. Norma më e madhe e ndryshimit mujor ishte në fund të muajit dhjetor prej +3.4%. Në këtë periudhë këto depozita arritën vlerën prej 606 mld lekë. Depozitat e siguresheme në valutë në muajin dhjetor 2020 përbëjnë 50.6% të totalit të depozitave të siguresheme, dhe kundërvlera e tyre në lekë ishte 620 mld lekë. Norma pozitive e ndryshimit mujor për depozitat në monedhë të huaj të konvertuara në lekë është evidentuar në dhjetë muaj të vitit,

Sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, shuma e kompensimit paguhet deri në nivelin maksimal të mbulimit, vetëm nëse kalon vlerën prej 100 lekësh.
Depozitat për kompensim të sistemit bankar në fund të vitit 2020, arritën 741.6 mld lekë, të cilat përfaqësojnë dhe detyrimin maksimal të Agjencisë kundrejt 1,710,112 depozituesve individë dhe tregtarë e shoqëri tregtare.

dhe rritja më e madhe prej 5.1%, e cila erdhi si rezultat i dobësimit të lekut kundrejt euros, u shënua në fund të muajit mars.

Peshën më të madhe të depozitave në monedhë të huaj, të shprehura në kundërvlerën e tyre në lekë, e zënë ato në euro me 43.8%. Gjatë vitit 2020 ecuria e depozitave në euro ka qenë në të dyja drejtimet, pozitive në gjashtë muaj të vitit, dhe negative për periudhën mars-korrik, dhe në muajin nëntor. Normat e ndryshimit mujor ishin relativisht të ulëta. Rënia më e madhe u shënua në muajin mars me -1.6%, por meqenëse leku u zhvleftësua me 6.5% kundrejt muajit të mëparshëm, kjo çoi në rritjen mujore të kundërvlerës në lekë të depozitave në euro me 4.7%. Në muajin prill ndryshimi mujor i depozitave në euro ishte -0.7%, por forcimi i lekut kundrejt euros në këtë muaj prej 5.5%, ndikoi në rënien prej 6.1% te depozitave në euro të konvertuara në lekë. Rritjen më të madhe depozitat në euro e shënuan në muajin gusht me 1.4%, dhe në dhjetor me 1.3%. Ndryshimi vjetor i depozitave në euro ishte +2.7%, duke korresponduar në vlerë 114 mln euro.

Gjatë vitit 2020 depozitat në dollarë, të konvertuara në lekë, kanë pasur një ecuri pozitive.

Ecuria e depozitave të siguresheme të sistemit sipas monedhave 2010 - 2020



Në fund të dhjetorit 2020, depozitat e siguresheme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 465 mld lekë (e shprehur në përqindje 38% të totalit të shumës së

depozitave të siguresheme), ndërsa depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 761mld lekë (ose 62% të totalit të shumës së depozitave të siguresheme).

Struktura e depozitave të siguresheme për kompensim krahasuar me limitin e mbulimit 2.5 mln-Dhjetor 2020



3.2.2. Depozitat e siguresheme të individëve.

Këto depozita në sistemin bankar më 31 dhjetor 2020 arritën 1,030 mld lekë, dhe përbëjnë pjesën më të madhe të totalit të depozitave të siguresheme, konkretisht 84% të tyre (norma e ndryshimit vjetor ishte 5.5%).

Ndikimin në rritjen vjetore prej 5.5% të depozitave të siguresheme të individëve, e kanë dhënë depozitat në lekë (pesha e tyre 50.4%), të cilat kanë shënuar një rritje në vlerë prej 34 mld lekë (në përqindje 7%), duke arritur në fund të dhjetorit 2020, shumën prej 519 mld lekë.

Në dhjetor 2020, depozitat në monedhë të huaj të shprehura në kundërvlerën në lekë kanë peshën 49.6%, dhe rritja vjetore e tyre ishte 4%. Depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë u rritën me 3.1%, ndërsa në monedhën origjinale u rritën me 1.4%. Këto depozita zënë peshën më të madhe të depozitave të individëve në monedhë të huaj prej

42.6%. Gjatë vitit 2020 ecuria e depozitave të individëve në euro ka qënë në të dyja drejtimet, negative për periudhën shkurt-korrik, dhe pozitive për pjesën tjetër të vitit, me norma të ndryshimit mujor relativisht të ulta. Rënia më e madhe u shënua në muajin mars me -0.7%, por meqënëse leku u zhvleftësua me 6.5% kundrejt muajit të mëparshëm, kjo çoi në rritjen mujore të kundërvlerës në lekë të depozitave në euro me 5.7%. Në muajin prill ndryshimi mujor i depozitave në euro ishte -0.1%, por forcimi i lekut kundrejt euros në këtë muaj prej 5.5%, ndikoi në rënien prej -5.6% te depozitave në euro të konvertuara në lekë. Rritja më e madhe depozitave në euro u shënua në muajt gusht e dhjetor përkatësisht me 0.69% dhe 0.65%.

Depozitat e individëve në usd të shprehura në kundërvlerën në lekë (pesha e tyre 4.7%) kanë shënuar rritje vjetore me 11.6 %, ndërsa në monedhën origjinale u rritën me 20%.

Struktura e shumës së depozitave të siguruesshme të individëve të sistemit sipas monedhave në %-dhjetor 2020



Gjatë vitit 2020, ecuria e depozitave të siguruesshme të individëve sipas nivelit të mbulimit ka qenë në të dyja kahet, pozitive dhe negative. Krahasuar me fundin e vitit 2019, depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë janë rritur me 4.5%, ndërsa depozitat me shuma mbi nivelin e mbulimit janë rritur me 34 mld lekë ose 6.2%. Meqenëse në dhjetor 2020, depozitat e individëve mbi nivelin e mbulimit kanë peshën më të madhe kundrejt totalit të depozitave të siguruesshme të individëve (56.8%),

ecuria në rritjen e tyre ka ndikuar në rritjen vjetore me 5.5% të depozitave të siguueshme të individëve.

Numri i depozituesve individë që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave në sistemin bankar, në fund të vitit 2020 është 2,515,973[1]. Ndër depozituesit individë me depozita më të mëdha se 100 lekë, 94% prej tyre ose 1,494,046 depozitues, i kanë depozitat deri në nivelin e mbulimit dhe përfitojnë mbulim të plotë nga skema e sigurimit të depozitave.

Depozituesit individë me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë në fund të dhjetorit 2020, janë 101,191 dhe shuma e depozitave të tyre arriti vlerën 585.4 mld lekë.

Ecuria e numrit të depozituesve individë të klasifikuar sipas nivelit të mbulimit 2010-2020



[1] Numri total i depozituesve është përcaktuar duke mbledhur të dhënat e agreguara të raportuara nga çdo bankë, kështu që një depozitues i cili ka depozita në disa banka është regjistruar disa herë. Në këtë numër ka depozitues me balancë zero deri në 100 lekë (minimumi ligjor për kompensim), të cilët në dhjetor 2020 janë 920,736.

Ecuria e depozitave të siguueshme dhe të siguruara të individëve 2010-2020



3.2.3. Depozitat e siguruara të individëve.

Depozitat e siguruara të individëve për sistemin bankar në fund të dhjetorit 2020 ishin në vlerën 697 mld lekë dhe përbëjnë 67.7% të vlerës së depozitave të siguueshme të individëve.

Ecuria e depozitave të siguruara të individëve në vlerë dhe ndryshimi vjetor në % 2010 – 2020



Ecuria e depozitave të siguruara të individëve në vlerë gjatë vitit 2020



Për periudhën 2010-2020, përqindja e depozitave të individëve me vlerë deri në 2.5 mln lekë, varion nga 40% deri në 44% të totalit të depozitave të siguueshme.

Ecuria e depozitave të individëve të klasifikuara sipas nivelit të mbulimit 2010-2020



3.2.4. Depozitat e siguruesh me të tregtarëve e shoqërive tregtare.

Për sistemin bankar, këto depozita në dhjetor 2020 arritën 196 mld lekë dhe gjatë vitit u rritën me 18.9%. Depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë u rritën me 13.1%, dhe pesha e tyre kundrejt totalit depozitave të siguruesh me të tregtarëve e shoqërive tregtare ishte 10.4%, ndërsa depozitat me shuma mbi 2.5 mln lekë (me peshë 89.6%), u rritën me 19.6%.

Sipas llojit të monedhës, ndikimin më të madh në rritjen vjetore prej 18.9% të depozitave të siguruesh me të tregtarëve e shoqërive tregtare, e kanë dhënë depozitat në lekë, me peshë 44%, dhe me rritje vjetore 27%. Depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë zënë peshën më të madhe të depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare prej 49.8% dhe shënuan një rritje vjetore me 10.4%, kurse në monedhën origjinale u rritën me 8.7%. Për depozitat në euro në monedhën origjinale, gjatë vitit 2020, ka dominuar ecuria pozitive dhe vetëm në muajt mars, prill e nëntor ka pasur ndryshim mujor negativ, përkatësisht me -6%, -3.4% dhe -1.5%. Rritjen më të madhe depozitat në euro e shënuan në muajin gusht me +5.2%, ndjekur nga muaji dhjetor me +4.2%. Depozitat në USD të shprehura në kundërvlerën në lekë zënë një peshë prej 5.6%, dhe krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën ndjeshëm me 41%, ndërsa në monedhën origjinale u rritën me 52%.

Struktura e shumës së depozitave të siguueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare të sistemit sipas monedhave në % - dhjetor 2020



Sipas kategorisë së produkteve, peshën më të madhe të depozitave të siguueshme për depozituesit tregtarë e shoqëritë tregtare e zënë llogaritë rrjedhëse, me 88%.

Struktura e shumës së depozitave të siguueshme të tregtarëve & shoqërive tregtare sipas produkteve - dhjetor 2020



Në ndryshim nga situata e depozitave të siguueshme të individëve, 89.6% e depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare janë me shuma mbi nivelin e mbulimit, dhe u korrespondojnë 9,555 depozituesve, të cilët përfaqësojnë 6.5% të depozituesve tregtarë e shoqërive tregtare. Pesha e kësaj kategorie depozituesish (me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë) si në numër ashtu edhe në shumë në dhjetor 2020 ka shënuar një rritje të lehtë krahasuar me fundin e vitit 2019.

3.2.5. Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare.

Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare gjatë vitit 2020 u rritën me 17.1% dhe në fund të këtij viti arritën vlerën prej 44.2 mld lekë. Ecuria e këtyre depozitave gjatë vitit 2020, ka qenë pozitive, vetëm në muajin prill shënuan një rënie me -2.2%.

Ecuria e depozitave të siguruara të tregtarëve & shoqërive tregtare në vlerë gjatë vitit 2020



3.3. Sigurimi i depozitave në shkk.

Depozitat në shkk në fund të vitit 2020 kanë regjistruar një rritje vjetore në masën 5.7%, krahasuar me 19% që është regjistruar në vitin 2019. Ndryshimi mujor në përqindje i depozitave përgjatë vitit 2020 është luhatur në intervalin 0.03% deri në 1.1%, krahasuar me intervalin 0.1% deri 2.8% që ishte përgjatë vitit 2019. Ngadalësimi i rritjes ka regjistruar një trajektore të shtrirë gjatë gjithë vitit 2020.

Ecuria e depozitave të shkk-2017 - 2020



Totali i depozitave të shkk-ve, në fund të vitit 2020 arriti në 8.7 mld lekë, nga 8.2 mld lekë që ishte në fund të dhjetorit 2019. Ndërsa, në fillim të vitit të parë të anëtarësimit në skemë (janar 2017) kjo shumë ishte 4.1 mld lekë.

Ecuria e depozitave të sigurueshme të shkk-ve gjatë periudhës Janar 2017-Dhjetor 2020



3.3.1. Depozitat e sigurueshme në shkk.

Këto depozita në fund të dhjetorit 2020 janë 8.5 mld lekë dhe zënë 98,3% të totalit të depozitave, kundrejt 8.1 mld lekë që ishin më datë 31 dhjetor 2019. Këto depozita i përfitojnë 39,153 depozitues të shkk-ve, kundrejt 23,455 depozituesve që përfitonin nga skema e sigurimit të depozitave më datë 31 dhjetor 2019.

> *"Depozitat e sigurueshme në shkk, përfshijnë depozitat me afat si dhe llogaritë mbështetëse të depozituesve/anëtarëve të shkk-së."*

Depozitat e sigurueshme në fund të dhjetorit 2020, janë rritur me 5% krahasuar me një vit më parë, ndërkohë që për vitin 2019 këto depozita u rritën me 19% krahasuar me vitin 2018, siç mund të vërehet në dy grafikët e mësipërm.

Në rritjen vjetore të depozitave të sigurueshme ndikim më të madh ka patur rritja e depozitave në lekë. Depozitat në lekë zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme të shkk-ve. Rritja vjetore e tyre është 5.3%.

Struktura e shumës së depozitave të siguueshme sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2020



Depozitat në monedhë të huaj zënë 17% të totalit të depozitave të siguueshme, si rezultat i faktit që vetëm një pjesë e shkk-ve kanë depozita në valutë. Në fund të dhjetorit 2020, depozitat e siguueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 3.2 mld lekë (e shprehur në përqindje 38% të totalit të shumës së depozitave të siguueshme), ndërsa depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 5.3 mld lekë (ose 62% të totalit të shumës së depozitave të siguueshme).

Struktura e depozitave të siguueshme për kompensim krahasuar me limitin e mbulimit 2 mln-Dhjetor 2020



3.3.2. Depozitat e siguruara në shkk.

Në fund të vitit 2020, depozitat e siguruara në SHKK janë 6.3 mld lekë. Kjo shumë përbën 73% të totalit të depozitave, ose 74.2% të depozitave të sigurueshme.

Ecuria e depozitave të siguruara sipas tremujorëve gjatë vitit 2020



Depozitat e siguruara që mbulohen plotësisht nga skema e sigurimit të depozitave, (të gjitha depozitat midis 101 deri 2 mln lekë) në 31 dhjetor 2020, arritën vlerën 3.2 mld lekë dhe përbëjnë 38% të totalit të depozitave të sigurueshme. Shuma e vlerësuar për sigurim për këto depozita, është e njëjtë me depozitat e siguruara plotësisht.

Depozitat e siguruara që mbulohen pjesërisht nga skema e sigurimit të depozitave, (depozitat më të mëdha se 2 mln lekë) arritën vlerën 5.3 mld lekë në 31 dhjetor 2020, dhe përbëjnë 62% të totalit të depozitave të sigurueshme. Shuma e vlerësuar për sigurim për depozitat që sigurohen pjesërisht është 3.1 mld lekë, dhe përbën 59% të totalit të depozitave të siguruara pjesërisht dhe 36% të totalit të depozitave të sigurueshme.

Ecuria e depozitave të siguruara përkundrejt totalit të depozitave të siguueshme sipas nivelit të mbulimit për tremujor



Ecuria e depozitave të siguruara sipas nivelit të mbulimit për tremujor



Numri i depozituesve që i kanë depozitat deri 2 mln lekë në fund të dhjetorit 2020 është 17,471. Këta depozitues përbëjnë 92% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave. Numri i depozituesve që i kanë depozitat në vlerën mbi 2 mln lekë në fund të dhjetorit 2020 është 1,553, dhe këta përbëjnë 8% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema.

Numri i depozituesve të siguruar gjatë vitit 2020 për tremujor



3.4. Procesi i verifikimit të subjekteve anëtare të skemës.

Agjencia gjatë vitit 2020, si rezultat i pandemisë Covid-19, kreu më së shumti verifikime on-line në të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Këto verifikime u kryen në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe u fokusuan kryesisht në raportimin e skedarëve për simulim/kompensim, për prodhimin e listë pagesës me paraqitjen unike të depozituesve. Nga verifikimi i kryer rezultoi se ka një përmirësim të dukshëm në kohën e ngarkimit të skedarëve dhe cilësisë së raportimit të tyre.

Agjencia në muajit prill qershor 2020 ka mbledhur informacion ditor, në mënyrë periodike mbi depozitat dhe lëvizjet e tyre nga të gjitha bankat dhe shkk-të për të identifikuar ndonjë rrezik potencial që në krye të herës. Janë mbajtur kontakte të drejtpërdrejta intensive me subjektet anëtare të skemës si gjatë kufizimit të lëvizjes dhe më tej deri sa u faktua që veprimtaria në

sistemin bankar dhe të shkk-ve nuk shfaqi luhatje, përkundrazi depozitat pas periudhës së pandemisë ishin në nivele më të larta se përpara saj.

Gjithashtu, Agjencia nuk ka shkëputur për asnjë moment nga vëmendja, informimin e depozituesve në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave. Duke mbajtur parasysh, që punonjësit e shërbimit me klientin janë përcjellësit e parë të informacionit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, Agjencia edhe në këtë vit të vështirë, ka organizuar takime, konsultime dhe trajnime on-line me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, duke i vënë theksin rëndësisë së përcjelljes saktë të informacionit tek depozituesit në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave, nga ana e këtyre punonjësve. Për të verifikuar shkallën e dijeve të punonjësve të shërbimit me klientin, Agjencia shpërndau një pyetësor on-line, në lidhje me procesin e kompensimit të depozitave. Ky pyetësor synonte që të freskonte dhe përmirësonte njohuritë e punonjësve të shërbimit me klientin në lidhje me një proces kompensimi, si dhe të ndihmonte në përditësimin e materialit trajnues të dedikuar, që Agjencia përgatit për punonjësit e shërbimit me klientin. Nga pyetësori rezultoi që punonjësit e shërbimit me klientin iu përgjigjën saktë rreth 90% të pyetjeve të hartuara.

Agjencia në trajnimet dhe takimet e organizuara on-line, një rëndësi të veçantë i dedikoi edhe hedhjes së saktë dhe të plotë të të dhënave të depozituesve në sistemet e subjekteve anëtare të skemës; si dhe përditësimit të këtyre të dhënave, nga punonjësit e shërbimit me klientin.

Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të Agjencisë.

4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka.

4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Në 31 dhjetor 2020, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 400 milion lekë dhe fitimet e akumuluara ndër vite, është 47,90 miliard lekë. Në krahasim me një vit më parë ky fond është rritur me rreth 4.71 miliard lekë ose 10.9%. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e fondit të sigurimit të depozitave për periudhën 2009 – 2020.

Fondi i sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)



4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Madhësia e fondit të sigurimit të depozitave në banka përcaktohet nga të ardhurat neto nga aktiviteti ndër vite. Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në banka janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në përputhje me Ligjin "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, duke filluar nga viti 2015, primi i sigurimit të depozitave përllogaritet në baza tremujore dhe jo më vjetore. Për bankat primi tremujor i sigurimit përllogaritet si 0.125% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm dhe për SHKK-të primi tremujor i sigurimit përllogaritet si 0.075% e mesatares aritmetike të

shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në SHKK në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Primi tremujor i sigurimit për subjektet anëtare të skemës së sigurimit paguhet jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet.

Primet e sigurimit në banka (në mijë lekë)



Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2020 ishin 3.57 miliard lekë ose 5.79% më të larta se në vitin 2019. Të ardhurat nga primet e sigurimit përgjatë periudhës 2009 – 2020 kanë qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e depozitave të siguruara në sistemin bankar në këto vite.

Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2020 ishin 1.22 miliard lekë ose 13.4% më shumë se në vitin 2019. Ky zë të ardhurash përgjatë periudhës 2009 – 2013 ka qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me zgjerimin e mjeteve financiare nën administrim dhe normat e interesit të letrave me vlerë. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare për vitet 2014-2017 janë ndikuar nga ulja e normave të interesit të letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptarë. Në vitin 2018 dhe 2020, rritja e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare ka ardhur kryesisht si rezultat i zgjerimit të portofolit në obligacione me maturitet 2 dhe mbi dy vjet. Gjatë vitit 2020 ka patur një rritje të normave të interesit duke patur kështu një kthim të kënaqshëm nga investimi. Gjatë këtyre viteve gjithashtu Agjencia ka synuar të realizojë një diversifikimi të portofolit në disa maturitete, gjë e cila ka ndikuar në rritjen e të ardhurave.

Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)



4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka.

Në fund të vitit 2020, depozitat e siguruara në sistemin bankar ishin 741.6 miliard lekë ose 5.52% më të larta se një vit më parë. Rritja e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka dhe ecuria më e moderuar e depozitave të siguruara në sistemin bankar gjatë periudhës 2009 – 2020 kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të raportit të mbulimit gjatë këtyre viteve. Në fund të vitit 2020, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 6.46%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në sistemin bankar dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2009 – 2020.

Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruara në banka (në mijë lekë)



4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në shkk.

4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në shkk.

Në përputhje me Ligjin '*Për sigurimin e depozitave*', i ndryshuar, në Janar të vitit 2015, u arkëtua nga Buxheti i Shtetit fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK në vlerë 76 milion lekë. Ky fond, siguroi bazën fillestare financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK. Duke nisur nga viti 2015 e në vazhdim, Agjencia ka administruar mjetet financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, të cilat hynë në skemë në Janar 2017. Në 31 dhjetor 2020, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 76 milion lekë, dhe fitimet e akumuluara, është rreth 144.70 milion lekë duke shënuar një rritje prej 16.14% krahasuar me vitin 2019.

Fondi i sigurimit të depozitave në SHKK (në mijë lekë)



4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në shkk.

Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në shkk janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, subjektet të cilat u pranuan për të hyrë në skemë nga Janari 2017, filluan të derdhin primet tremujore të sigurimit. Gjatë vitit 2020 nuk ka ndryshim të numrit të shoqatave të kursim-kreditit në skemën e sigurimit të depozitave.

Të ardhurat nga primet e sigurimit për të gjithë vitin 2020 ishin 18.54 milion lekë.

Primet e sigurimit në SHKK (në mijë lekë)



Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK përgjatë gjithë vitit 2020 ishin në shumën 1.97 milion lekë e cila krahasuar me vitin 2019 është rritur me 14.92 %.

Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK (në mijë lekë)



Në fund të vitit 2020, depozitat e siguruara për SHKK-të ishin rreth 6.3 miliard lekë ose 17.56% më të larta se një vit më parë. Në fund të vitit 2020, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në shkk në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 2.28%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në shkk-të dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2017 – 2020.

Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruara në SHKK (në mijë lekë)



4.3. Administrimi i mjeteve financiare.

Më 31 Dhjetor 2020, mjetet financiare të Agjencisë, me vlerë nominale 47.41 miliard lekë, janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, në depozita një javore ose gjendje në llogari pranë Bankës së Shqipërisë ose bankës kujdestare Raiffaisen Bank International. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me politikën e investimit në fund të vitit 2020 kishte 14% të portofolit në instrumente shumë likuid, si depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë dhe në disa banka ku Agjencia mban llogari për aktivitetin operacional si edhe letra me vlerë me maturitet të mbetur deri në 90 ditë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas transheve të investimit më 31 Dhjetor 2020.

Mjetet financiare sipas transheve të investimit



Mjetet financiare të Agjencisë janë në masën më të madhe në lekë. Agjencia mban edhe një pjesë të mjeteve të saj financiare në valutë Euro. Në përputhje me Politikën e Investimeve, investimet në monedhe të huaj përbëjnë 8.2 % të mjeteve financiare nën administrim dhe në planin afatgjatë synohet afrimi i strukturës sipas monedhës për portofolin e Agjencisë me atë të depozitave të siguruara. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas valutës më 31 Dhjetor 2020.

Mjetet financiare sipas valutave



Në grafikun që vijon paraqitet shpërndarja e mjeteve financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim më 31 Dhjetor 2020. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, mjetet financiare kanë një shpërndarje të shkallëzuar sipas kohëzgjatjes deri në maturim.

Pas miratimit të Ligjit nr. 53/14 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, Agjencia ka zhvendosur rreth 60% të portofolit të saj të investimit në instrumente me maturitet të mbetur nga 3- 24 muaj dhe rreth 26% të portofolit të saj në instrumente me maturitet të mbetur mbi 24 muaj.

Mjetet financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim



Seksioni 5 – Projektet e realizuara për fuqizimin e skemës së sigurimit të depozitave.

5.1 Projekti për vlerësimin e parametrave financiarë të skemës së sigurimit të depozitave.

Në muajin janar 2020 ASD nisi projektin për vlerësimin e parametrave financiarë të skemës së sigurimit të depozitave. Ky projekt pati mbështetjen e Bankës Botërore nëpërmjet programit FINSAC. Grupi i ekspertëve të angazhuar zotëronte eksperiencë të gjatë në fushën e sigurimit të depozitave, në shumë vende të botës. Projekti u nda në dy faza. Faza e parë përfshinte analizën e nivelit të mbulimit për banka dhe shkk, ndërsa faza e dytë u përqendrua në përllogaritjen optimale të fondit varësisht nga industria bankare në vendin tonë. Në kuadër të këtij programi ekspertët e Bankës Botërore bënë takime në Bankën e Shqipërisë me departamentet e Mbikëqyrjes, Stabilitetit Financiar dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

Faza e parë analizoi nivelin e mbulimit për bankat dhe shkk bazuar në tre faktorë.

a. Niveli i sigurimit të depozitave aktual përkundrejt nivelit të mbulimit total. U analizuan disa nivele rritjeje të nivelit të sigurimit të depozitave dhe efekti që do të kishin në mbulimin e një numri më të madh depozituesish. U vu re se një rritje e nivelit të depozitave edhe me 50% do të sillte një rritje të papërfillshme prej 1,7 % në numrin e depozituesve të siguruar. Për rrjedhojë nuk u vlerësua e efektshme një rritje në këtë analizë.
b. Niveli i sigurimit të depozitave aktual kundrejt kushteve ekonomike (të ardhurave për frymë) në vendin tonë. U vlerësua që në Shqipëri niveli i raportit nivel mbulimi/GDP për frymë popullsie është mbi medianën e vendeve të tjera të krahasueshme me ne për nga niveli i të ardhurave në botë dhe në Ballkan.
c. Presioni nga skemat konkurrente. Ekziston mundësia që vende të afërta, në të cilat depozituesit shqiptarë mund të kenë akses, të kenë nivele më të larta mbulimi dhe kjo mund të shkaktojë një zhvendosje të depozitave jashtë vendit. Pavarësisht se vendet pranë nesh pjesë e BE-së dhe kanë nivel mbulimi 4 herë më të lartë, nga të dhënat empirike nuk është vërejtur asnjëherë një zhvendosje e depozitave jashtë sistemit bankar shqiptar. Kjo

lidhet me faktin se skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri ofron për depozituesit mundësinë që të ndajnë depozitat e tyre në disa banka për të siguruar një pjesë më të madhe të kursimeve të tyre.

Në përfundim të kësaj faze u vlerësua se nuk ka vend për rritje të nivelit e mbulimit të depozitave të siguruara. Me nivelin e depozitave të siguruara prej 2.5 milion lekë për bankat dhe 2 milion lekë për shkk mbulohen respektivisht 96.1%[2] e depozituesve dhe 38.3% e depozitave për bankat dhe 93.3% e depozituesve dhe 38.6% e depozitave për shkk. Këto nivele janë edhe në përputhje me parimet bazë për një skemë efektive për sigurimin e depozitave të IADI-it[3], të cilat janë pranuar ndërkombëtarisht si standardet më të mira në fushën e sigurimit të depozitave.



Në fazën e dytë, e cila u krye nëpërmjet komunikimit në distancë, ekspertët analizuan situatën hipotetike të përkeqësimit të cilësisë së kredisë në sistemin bankar në atë shkallë sa do mund të shkaktonte një ngjarje sigurimi dhe nëse fondi për sigurimin e depozitave në banka do të ishte i mjaftueshëm në këtë rast. Për këtë analizë është përdorur një metodologji stres-test e përafërt me atë të përdorur nga Autoriteti Mbikëqyrës dhe e rekomanduar nga FMN. Për qëllime të analizave të Agjencisë kjo metodologji shtrihet në dy vite të njëpasnjëshme. Në analizë u vlerësuan dy elementë, likuiditeti i nevojitur dhe madhësia e duhur e fondit. Në përfundim ekspertët rekomanduan një nivel të synuar të fondit prej 7 për qind. Për të përvetësuar metodologjinë punonjësit e agjencisë u trajnuan dhe ekzekutuan metodën e stres-testit me të dhëna të përditësuara dhe u arrit në një rezultat të ngjashëm me ata të ekspertëve.

[2] Kjo fazë e projektit është kryer në shkurt 2020 dhe shifrat janë bazuar mbi të dhënat e fundit të vitit 2019.
[3] IADI – International Association of Deposit Insurers (Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave).

5.2. Projekti për krijimin e masterplanit të një sistemi të integruar të sigurimit të depozitave.

Gjatë vitit 2020 u zhvillua projekti për krijimin e masterplanit të një sistemi të integruar për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Projekti u realizua me asistencën e Korporatës Koreane të Sigurimit të Depozitave. Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe Korporata Koreane e Sigurimit të Depozitave kanë pasur gjatë viteve marrëdhënie të konsoliduara dhe intensive bashkëpunimi bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2014 dhe rinovuar në vitin 2019.

Projekti, i cili u shtri në një afat kohor prej 6 muajsh, synoi këshillimin në lidhje me Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë. Ai kishte për qëllim analizën e sistemit IT dhe kuadrit ligjor, rregullativ dhe operacional në të cilin ai operon, vlerësimin e ambientit ekzistues për krijimin e modulit për menaxhimin e riskut si edhe përgatitjen e një dizajni të detajuar për përmirësimin dhe krijimin e moduleve të reja për kryerjen e pagesave në një proces kompensimi. Projekti u finalizua me përgatitjen e një modeli të ardhshëm për sistemin dhe planin e tij të zhvillimit. Kontributi kryesor i këtij projekti është hartimi i termave të referencës, të cilat do të shërbejnë si 'guri i themelit' për përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit IT të Agjencisë në lidhje me procesin dhe kompensimin e depozitave. Zhvillimet e reja, të cilat do të mbështeten mbi këto terma reference, do të mundësojnë verifikimin e depozituesve në një proces kompensimi si edhe evidentimin e gjurmimin e pagesës së kompensimit. Gjithashtu, përfshin implementimin e modulit të përpunimit të ankesave të mundshme të depozituesve në një ngjarje sigurimi, si edhe ndërtimin e një ambienti raportimi që do të mundësojë një paraqitje dhe administrim më të mirë të sistemit informacionit në Agjenci.

Seksioni 6 – Mirëqeverisja e institucionit.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është një institucion publik themeluar në vitin 2002 që ushtron aktivitetin në bazë të Ligjit nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar. Agjencia gëzon pavarësi operacionale dhe financiare nga çdo subjekt tjetër, në zbatim të dispozitave të Ligjit "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Strukturat qeverisëse të Agjencisë dhe proceset e punës sigurojnë vënien në zbatim të strategjive të miratuara dhe administrimin e riskut në të gjitha aspektet e aktivitetit të institucionit. Kontrollet e brendshme përfshijnë, ndër të tjera, kodin e etikës, deklarimet e konfliktit të interesit, ndarjen e detyrave, etj. Këshilli Drejtues i Agjencisë luan një rol të rëndësishëm në vendosjen dhe ruajtjen e një sistemi efikas të menaxhimit të riskut dhe kontrolleve të brendshme, duke i kushtuar rëndësi të veçantë etikës, kulturës së punës dhe standardeve operacionale.

Siç përcaktohet në Ligj, Agjencia raporton në Kuvend, në Këshillin e Ministrave dhe në Autoritetin Mbikëqyrës për veprimtarinë vjetore të saj. Shërbimi i auditit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për vitin 2020 është kryer nga kompania PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (IPPF). Auditimi i brendshëm përfaqëson një nga funksionet më të rëndësishme në veprimtarinë e Agjencisë. Ai është një element thelbësor, i cili siguron organet drejtuese dhe vendimmarrëse të Agjencisë, se të gjitha veprimet, procedurat dhe operacionet e njësive organizative dhe subjekteve të tjera të përfshira në veprimtarinë e saj, mbulohen me auditim dhe janë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për këtë qëllim.`

6.1. Këshilli Drejtues.

Bazuar në Ligin "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar dhe Statutin e Agjencisë organi më i lartë drejtues është Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës. Dy anëtarë propozohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutivë,

me përjashtim të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Ligji "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar, përcakton se afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje, bazuar në treguesit e performancës të veprimtarisë së tyre.

Gjatë vitit 2020 Këshilli Drejtues i Agjencisë ka pasur disa ndryshime në përbërjen e tij, të cilat identifikohen në tabelën më poshtë.

KËSHILLI DREJTUES	FUNKSIONI	INSTITUCIONI PROPOZUES
Donald Duraj	Kryetar	Banka e Shqipërisë
Genci Mamani	Anëtar	Banka e Shqipërisë
Adelina Xhemali[4]	Anëtar	Ministri i Financave
Majlinda Demko[5]	Anëtar	Ministri i Financave
Nexhmije Çela	Anëtar	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)

Bazuar në detyrimin që në çdo kohë të veprojnë me ndershmëri në interesin më të mirë të Agjencisë, anëtarët e Këshillit Drejtues ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin "Për Sigurimin e Depozitave", i ndryshuar, Statutin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Rregulloren "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave" dhe legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale.

Procesi i vendimmarrjes i Këshillit Drejtues, përgjatë vitit 2019, është udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës. Këshilli Drejtues në vitin 2020 e ushtroi aktivitetin e tij nëpërmjet platformave teknologjike të komunikimit në

[4] Emëruar me Urdhër Nr. 3203, datë 10.07.2020 të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.
[5] Emëruar me Urdhër Nr. 3205, datë 10.07.2020 të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.



përputhje me kufizimet e vendosura nga autoritetet përgjegjëse si pasojë e pandemisë së Covid-19 dhe aktet nënligjore të Agjencisë. Mbledhjet e Këshillit Drejtues gjatë vitit 2020 janë organizuar me një frekuencë të përmuajshme. Vendimmarrja e Këshillit Drejtues ka prodhuar 39 vendime në funksion të vendosjes dhe ruajtjes së standardeve të larta në mirëqeverisjen e Agjencisë si dhe konsolidimin e kapaciteteve të saj për të përmbushur mandatin ligjor. Vendimmarrja e Këshillit u përqendrua kryesisht në miratimin e akteve nënligjore me qëllim miradministrimin e skemës së sigurimit të depozitave si dhe mbarëvajtjen operacionale të Agjencisë.

6.2. Struktura organizative.

Struktura organizative e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave", i ndryshuar.

Bazuar në Statutin e Agjencisë miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018 dhe në zbatim të strukturës së saj organizative Agjencia organizohet në mënyrë hierarkike, drejtohet nga Këshilli Drejtues dhe administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Sipas kësaj strukture Agjencia është e përbërë nga 7 sektorë, dhe ka në total një staf prej 29 punonjësish.



Gjatë vitit 2020 stafi ka pasur një qëndrueshmëri të vazhdimësisë së tij, në vijim kjo edhe të politikave të saj për motivimin profesional të tyre. Gjithashtu gjatë vitit 2020 struktura organizative e Agjencisë nuk ka pësuar ndryshime.

Menaxhimi i kapitalit njerëzor si një nga prioritetet strategjike të Agjencisë, synon të promovojë standarde të larta profesionale dhe etike, si dhe të krijojë një ambient pune avantazhues për punonjësit.

Në përputhje me Prioritetin Strategjik II, Menaxhimi i kapitalit njerëzor, të Planit Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2018 – 2020, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 14, datë 31.05.2018, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, gjatë vitit 2020 hartoi 'Strategjinë e menaxhimit dhe zhvillimit të Burimeve Njerëzore'. Hartimi i kësaj strategjie ka për qëllim të sjellë një vlerë të shtuar në menaxhimin me efektivitet të burimeve njerëzore të Agjencisë dhe synon t'i shërbejë menaxhimit sa më optimal të kapaciteteve profesionale, si edhe të orientojë përdorimin me sa më shumë efikasitet të këtyre burimeve, sipas politikave të zhvillimit të institucionit. Strategjia për zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në Agjenci, është pjesë integrale e strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe objektivat e synuara, si edhe iniciativat që identifikohen për realizimin e tyre, janë në funksion të realizimit të objektivave strategjikë të saj. Në fokus të kësaj strategjie është zhvillimi dhe mbajtja e një mjedisi konkurrues profesional dhe social, i cili kontribuon në rritjen e besimit të punonjësve te punëdhënësi. Gjithashtu ajo synon motivimin dhe plotësimin e kënaqësisë në punë dhe të rritjes profesionale të punonjësve, duke mundësuar ruajtjen dhe përmirësimin e mirëqenies sociale të tyre në përputhje me kuadrin ligjor.

Seksioni 7 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Deloitte.

Deloitte Albania shpk
Rr. Faik Konica, Ndërtesa nr. 6,
Hyrja nr. 7, 1010
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave ("Agjencia"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2020 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Agjencisë në përputhje me Ligjin Nr. 53/2014, datë 22 maj 2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar dhe me Nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart, kur, të na vihen në dispozicion dhe, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat finaciare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Agjencisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Agjencisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmeri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Agjencisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Agjencisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Agjencisë për vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Agjencisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010, Tirana, Albania
Tiranë, Shqipëri
Numri i identifikimit unik të subjektit (NUIS): L41709002H

DELOITTE AUDIT ALBANIA
Rr. "Faik Konica" Ndërtesa Nr.6 Hyrja Nr.7, 1010 Tiranë
TIRANË - ALBANIA
NUIS: L 41709002 H
Tel: 044517920

Partner Angazhimi
Auditues Ligjor
Enida Cara

Tiranë, Shqipëri
26 shkurt 2021

Pasqyra e pozicionit financiar.

	Shënime	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	2,387,437,946	3,035,714,526
Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale	9	45,599,089,145	40,212,956,768
Aktive afatgjata materiale, neto	10	57,755,798	60,096,842
Aktive afatgjat0a jo materiale, neto	11	3,074,834	6,201,241
Aktive të tjera, neto	12	4,514,600	4,335,660
TOTALI I AKTIVEVE		**48,051,872,323**	**43,319,305,037**
DEYRIMET			
Detyrime të tjera	13	6,930,333	6,354,320
TOTALI I DETYRIMEVE		**6,930,333**	**6,354,320**
FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE			
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	14	400,000,000	400,000,000
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në Shoqëri Kursim Krediti (“SHKK”)	14	76,000,000	76,000,000
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka		47,500,232,112	42,788,356,194
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK		68,709,878	48,594,523
TOTALI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		**48,044,941,990**	**43,312,950,717**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		**48,051,872,323**	**39,024,787,264**

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithpërfshirëse.

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura operative:			
Të ardhura nga primet e sigurimit	15	3,590,102,779	3,392,642,125
Të ardhura nga kontributet fillestare	16	80,164	-
Të ardhura nga interesat	17	1,227,990,771	1,082,420,273
Të ardhura të tjera operative	18	1,504,175	1,044,996
		4,819,677,889	**4,476,107,394**
Shpenzime financiare:			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		37,338,299	(39,878,999)
Shpenzime të tjera financiare	19	(4,493,905)	(12,620,913)
		32,844,394	**(52,499,912)**
Shpenzime operative:			
Shpenzime personeli	20	(79,892,504)	(81,706,506)
Shpenzime administrative	21	(25,944,801)	(35,768,425)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	(8,795,656)	(8,698,863)
		(114,632,961)	**(126,173,794)**
Rimarrje/(Shpenzime) provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	8, 9	(5,898,049)	1,327,975
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN		**4,731,991,273**	**4,298,761,663**
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		**-**	**-**
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE		**4,731,991,273**	**4,298,761,663**

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin		**4,731,991,273**	**4,298,761,663**
Rregullime për:			
Të ardhura nga interesat	17	(1,227,990,771)	(1,082,420,273)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	8,795,656	8,698,863
Levizja në fondin e provigjonit për instrumentet financiare	9	11,230,935	(2,855,979)
Ndryshimet në:			
Aktive të tjera		(178,939)	(471,255)
Detyrime të tjera		1,077,205,959	(4,243,891)
Interesi i arkëtuar		576,013	872,079,353
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ		**4,601,630,126**	**4,089,548,481**
AKTIVITETI INVESTUES			
Blerje e aktiveve afatgjata	11	(3,328,205)	(1,523,002)
Blerje e instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale		(5,246,578,501)	(6,402,701,500)
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues		**(5,249,906,706)**	**(6,404,224,502)**
Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit		**(648,276,580)**	**(2,314,676,021)**
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8	3,035,714,526	5,350,390,547
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	**8**	**2,387,437,946**	**3,035,714,526**

Pasqyra e ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave.

	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK	Totali
Më 1 janar 2019	**400,000,000**	**76,000,000**	**38,506,676,717**	**31,512,337**	**39,014,189,054**
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	4,281,679,477	17,082,186	4,298,761,663
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	**4,281,679,477**	**17,082,186**	**4,298,761,663**
Më 31 dhjetor 2019	**400,000,000**	**76,000,000**	**42,788,356,194**	**48,594,523**	**43,312,950,717**
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	4,711,875,918	20,115,355	**43,312,950,717**
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	**4,711,875,918**	**20,115,355**	**43,312,950,717**
Më 31 dhjetor 2020	**400,000,000**	**76,000,000**	**47,500,232,112**	**68,709,878**	**48,044,941,990**

Seksioni 8 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

8.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Me ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 "Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë" , Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i janë caktuar kompetencat për administrimin e këtij fondi. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është kryer në përputhje me Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, miratuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë. Fondi është bërë efektiv duke filluar nga data 1 Janar 2018. Banka e Shqipërisë është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që ushtron të drejtat e ndërhyrjes të përcaktuara në Ligj. Banka e Shqipërisë përllogarit çdo vit kontributin vjetor që sektori bankar do të paguajë për arritjen e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Kontributi vjetor i paguar nga Bankat për vitin e parë ishte në shumën 632.42 milion lekë dhe për vitin e dytë 650.33 milion lekë, dhe për vitin 2020 ishte 654.20 milion lekë. Në 31 dhjetor 2020, vlera kontabël e aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është 1.994 miliard lekë.

Mjetet financiare të Fondit janë investuar në përputhje me strategjinë vjetore të investimit për vitin 2020, miratuar nga Komiteti i Investimeve i Agjencisë. Këto mjete financiare me vlerë nominale 1.991 miliard lekë në 31 dhjetor 2020, janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe depozita nje javore e llogari rrjedhese pranë Bankës së Shqipërisë. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare të këtij fondi, Agjencia në përputhje me politikën e administrimit të mjeteve financiare në fund të vitit 2020 kishte 13.7% të portofolit në instrumente shumë likuid, si llogari rrjedhëse dhe depozita me Bankën e Shqipërisë dhe letra me vlerë me maturitet të mbetur deri në 90 ditë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas transheve të investimit më 31 Dhjetor 2020.

Mjetet financiare sipas transheve të investimit



Mjetet financiare të FNJ janë në masën më të madhe në lekë. Në përputhje me Politiken e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, investimet në monedhë të huaj përbëjnë 6% të mjeteve financiare nën administrim. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas valutës më 31 Dhjetor 2020.

Mjetet financiare sipas valutave



Agjencia për llogari të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtzakonshme, administron dhe mban llogari të veçanta kontabël për mjetet financiare të këtij fondi. Agjencia përgatit dhe raporton pranë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme portofolin e mjeteve financiare të Fondit si edhe pasqyrat financiare tremujore të tij. Pasqyrat Financiare vjetore të Fondit auditohen nga shoqëri auditimi të çertifikuara e të pavarura

8.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Deloitte.

Deloitte Albania shpk
Rr. Faik Konica, Ndërtesa nr. 6,
Hyrja nr. 7, 1010
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Këshillit Drejtues të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2020 si dhe performancën e tij financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Agjencisë në përputhje me Ligjin Nr. 53/2014, datë 22 maj 2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar dhe me Nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart, kur të na vihen në dispozicion dhe, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat finaciare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondit, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabël, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit.

Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmeri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Fondit për vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare (Vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Fondit, përveçse çështjeve të tjera, edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

Deloitte Audit Albania Shpk
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010 Tiranë, Albania
Tiranë, Shqipëri
Numri i identifikimit unik të subjektit (NUIS): L41709002H

DELOITTE AUDIT ALBANIA
Rr. "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010 Tiranë
ALBANIA
NIPT: L 41709002 H
Tel: 0445 1920

Partner Angazhimi
Auditues Ligjor
Enida Cara

Tiranë, Shqipëri
26 shkurt 2021

Pasqyra e pozicionit financiar.

	Shënime	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	26,016,761	255,035,598
Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale	9	1,970,600,212	1,050,529,040
TOTALI I AKTIVEVE		**1,996,616,973**	**1,305,564,638**
DEYRIMET			
Detyrime të tjera	10	2,365,622	1,976,995
TOTALI I DETYRIMEVE		**2.365,622**	**1,976,995**
AKTIVET NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME			
Aktivet neto në dispozicion të ANJ		1,303,587,643	636,675,433
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		690,663,708	666,912,210
TOTALI AKTIVEVE NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME		**1,994,251,351**	**1,303,587,643**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE I AKTIVEVE NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME		**1,996,616,973**	**1,305,564,638**

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithpërfshirëse.

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura operative:			
Të ardhura nga kontributi vjetor	11	654,202,246	650,332,126
Të ardhura nga interesat	12	38,144,496	20,203,798
		692,346,742	**670,535,924**
Shpenzime financiare:			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		888,001	(1,543,602)
Tarifa dhe komisione bankare	13	(505,000)	(500,000)
		383,001	**(2,043,602)**
Shpenzime operative:			
Shpenzime operative nga aktiviteti	14	(1,860,625)	(1,476,995)
		(1,860,625)	**(1,476,995)**
Rimarrje/(Shpenzime) provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	8	(205,410)	(103,117)
TEPRICA NETO PËR VITIN		**690,663,708**	**666,912,210**
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE		**690,663,708**	**666,912,210**

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin		**690,663,708**	**666,912,210**
Rregullime për:			
Të ardhura nga interesat		(38,144,496)	(20,203,798)
Lëvizja në fondin e provigjonit për instrumentet financiare		326,977	-
Ndryshimet në:			
Detyrime të tjera		388,627	662,386
Interesi i arkëtuar		32,356,348	19,373,558
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ		**685,591,163**	**666,744,356**
AKTIVITETI INVESTUES			
Blerje e instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale		(914,610,000)	(478,000,000)
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues		**(914,610,000)**	**(478,000,000)**
Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit		**(229,018,837)**	**188,744,356**
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8	**255,035,598**	**66,291,242**
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	8	**26,016,761**	**255,035,598**

Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

	Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme	Totali
Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 1 janar 2019	**636,675,433**	**-**
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	666,912,210	636,675,433
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	**666,912,210**	**636,675,433**
Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2019	**1,303,587,643**	**636,675,433**
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	690,663,708	666,912,210
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	**690,663,708**	**666,912,210**
Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2020	**1,994,251,351**	**1,303,587,643**